



Planuar / Dërguar Prilbena / Predato Received / Delivered	29.03.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Pr Prof Pr Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK	3122/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.35/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1874/2021 të datës 08.02.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.35/2020 të datës 14.02.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë _____, kundër organit të punësimit-Akademia e Drejtësisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.35/2020 e datës 14.02.2020 e parashtruar na ankuesi

A r s y e t i m

Akademia e Drejtësisë, më datë 16.07.2019, më datë 09.10.2019 dhe më datë 21.01.2020 ka dërguar Kërkesë për përcaktimin e shtesave në pagë tek Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil i Ministrisë së Administratës Publike për shtesat në pagë për profesionet deficitare për ankuesin, i cili në bazë të Akt Emërimit të datës 16.07.2019 mban pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji" në Akademinë e Drejtësisë.

Lidhur me kërkesat e parashtruar Akademia e Drejtësisë nuk ka pranuar përgjigje.

Ankuesi, më datë 14.02.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 360/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.02.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit me numër protokoli 452/2020 tek Akademia e Drejtësisë. Ndërsa më datë 02.03.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me numër protokoli 533/2020 bashkë me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 19.05.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 08.02.2023 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1874/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 19.05.2020 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 14.02.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 14.02.2020 me numër protokoli 360/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përcaktimin e shtesave në pagë me Nr. Prot:439 e datës 09.10.2019 e Akademisë së Drejtësisë; Kërkesën për përcaktimin e shtesave në pagë me Nr. Prot:02/09/2020 e datës 21.01.2020 e Akademisë së Drejtësisë; Akt Emërimin e datës 16.07.2019 të ankuesit; Lista e pagave e muajit 28.01.2020; lista e pagave e datës 24.12.2019; lista e pagave e datës 30.11.2019; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 16.07.2019; Kërkesë për përcaktimin e shtesave në pagë e datës 16.07.2019 me nr. protokoli 367; E-mal zyrtar i datës 18.10.2019; Kërkesë për përcaktimin e shtesave në pagë e datës 21.01.2020 me nr.protokoli 108; E-mailin e datës 04.02.2020 nga I.S; Formulari i shpenzimit të Departamentit , Divizionit dhe Sektorit i datës 21.02.2020; Formulari i shpenzimit të Departamentit , Divizionit dhe Sektorit i datës 22.02.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 24.12.2019; Diploma e datës 22.02.2009 , nr.92 e lëshuar nga fakulteti i Shkencave të Aplikuara Teknike në Universitetin e Prishtinës; Çertifikatë e datës 24.05.2000; Çertifikatë e datës 15.01.2000; Çertifikatë e datës 21.06.2010; Çertifikatë e datës 12.06.2013; Çertifikatë e datës 28.05.2016; Çertifikatë e datës 17.03.2017; Çertifikatë e datës 08.09.2017; Çertifikatë e datës 16.01.2018; Çertifikatë e datës 11.02.2014; Çertifikatë e datës 22.02.2019; Çertifikatë e datës 08.09.2017; Çertifikatë e datës 08.01.2019; Çertifikatë e datës 27.05.2014; Çertifikatë e datës 12.09.2014; Mirënjohje e datës 29.12.2014; Çertifikatë e datës 18.05.2016; Çertifikatë e datës 21.06.2014; Çertifikatë e datës 17.06.2016; Çertifikatë e datës 13.09.2017; Çertifikatë e datës 24.02.2016; Çertifikatë e datës 21.06.2014; Çertifikatë e datës 09.09.2011; Vërtetimi i datës 13.06.2016 me nr.02/97/2016; Njoftimi i datës

13.08.2021 i KPMSHCK-së dhe Aktgjykimin A.nr.1874/2021 të datës 08.02.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është e pabazuar, **SEPSE:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitive dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informative dhe inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, së paku një herë në gjatë muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: *1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Përkritazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.02/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhëne edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka arritur të konstatojë se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me



ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analizë që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitave përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke marr parasysh objektin e kësaj ankese, thekson edhe faktin se më datë 05.02.2023 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ku si rrjedhojë me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publik, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave, për më tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.35/2020, datë 29/03/2023

Sabile AVDYLI


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Akademinë e Drejtësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.